



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
Regulatorna Komisija Javne Nabavke
Public Procurement Regulatory Commission

REPublika e Kosovës REPublika KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KRPP - RKJN - PPRC	
Nr.	95/2011
Dt.	06.06.2011



UDHËZIMIN ADMINISTRATIV Nr. 06/2011/KRPP

Duke u bazuar në nenin 87, paragrafin 2, nën-paragrafin 2.5 të Ligjit Nr. 03/L-241 për Prokurimin Publik, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik nxjerr:

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është që të sqarohen dhe korrigjohen keqkuptimet e shpeshta në lidhje me Dosjet e Tenderëve, veçanërisht Listën e Çmimeve në Formularin e Dorëzimit të Tenderit në lidhje me Ligjin e Prokurimit Publik nr. 03/L-241.

Neni 2 Termet e Përdorura

Shprehjet e përdorura në këtë udhëzues, kanë kuptimin e përkufizimeve të përcaktuara me nenin 4 të Ligjit Nr.03/L-241 për Prokurimin Publik.

Neni 3 Specifikimet e sasive në tenderë dhe kontrata

Autoritetet Kontraktuese duhet të specifikojnë sasi të në çdo tender dhe kontratë të ekzekutuar. Ky obligim i përket të gjithë tenderëve dhe kontratave.

Si rrjedhojë, Autoritetet Kontraktuese nuk duhet të fshijnë informacionet në lidhje me sasi të veçanërisht në Listën e Çmimeve, aty ku Operatorët Ekonomik duhet të plotësojnë çmimet dhe përmes shumëzimit të sasive dhe çmimeve të arrijnë shumen totale apo çmimin e tenderit të tyre. Sasi të në Listën e Çmimeve duhet të tregohen në mënyrë të qartë për të lejuar transparencën dhe për të mundësuar që operatorët ekonomik të përgatitin tenderët e tyre në mënyrë që pasqyrojnë konsumin e paraparë.

Kontratat kornizë duhet të përdoren në çdo rast ku sasi të ekzakte të mallrave dhe shërbimeve janë të panjohura gjatë periudhës kontraktuese. Në raste të tilla, Autoritetet Kontraktuese duhet të specifikojnë një sasi të parashikuar të kontratave. Parashikimi duhet të bëhet në bazë të konsumit të ditur dhe të korrigjuar për variacione të ditura apo të pritura.

Kontrata gjithashtu duhet të pasqyroj sasi të që do të liferohen.

Neni 4
Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktues

Autoritetet Kontraktuese duhet të sigurojnë që kërkesat e LPP dhe te Legjislacionit Sekondarë në lidhje me Ligjin janë plotësuar dhe që dokumentacioni në lidhje me tenderët përgatitet në mënyrë të qartë dhe transparente. Kjo ka të bëjë veçanërisht me pjesët e dokumenteve që përmbajnë udhëzime në lidhje me tenderët që janë drejtuar Operatorëve Ekonomikë.

Në përputhje me rrethanat, çdo tender dhe kontratë duhet të përcaktojë qartë sasishtë në lidhje me tenderin.

Neni 5
Hyrja në Fuqi

Ky udhëzim administrativ hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik.

Data 06.06.2011


Safet Hoxha
Kryetar i KRPP-së, Prishtinë

